



Implemented by



Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

QENDRA E STUDIMEVE TE BIOEKONOMISE, BUJQESISE, USHQIMIT DHE ZHVILLIMIT RURAL

Corovode, Skrapar 5.02.2017

Lënda: *Raporti i punes per Grupin i Fermerëve te Frutoreve dhe Arroreve, Çorovode-Skrapar, 4-5 shkurt*

Drejtuar: *Zj. Qamile Gishti,
Koordinatorë Rajonale e Beratit, GIZ/SARED*

Zj. Gishti,

Me dt.4.02.2017, u zhvilluat takimi me grupin e fermerëve të frutoreve e arroreve në Çorovode-Skrapar. Qëllimi ishte prezantimi i raport vlerësimeve të analizave të përberjes së tokës për çdo fermer, i skemave dhe periudhës së plehimit, si dhe llojet e plehrave sipas nivelit të prodhimit. Analizat e tokës janë realizuar nga *Laboratori i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës*. Prezantimi i vlerësimeve të analizës u realizua nga eksperti Bardhosh Ferraj.

Për çdo fermer ishte përparitur material i veçantë për skemën e plehimit, në varesi të analizave të tokës, duke përcaktuar sasinë e plehrave që do të përdoren sipas ciklit të prodhimit dhe niveleve të prodhimit. U trajtuan të gjitha skemat e plehimit duke filluar nga ai i gjelër, me pleh organik dhe me plehera kimike, duke theksuar gjithashtu edhe ruajtjen e mjedisit.

Takimi u konsideruan shumë i rëndësishëm, dhe fermerëve ju shpërndanë materialet e prezantuar në takim në lidhje me analizat e tokës dhe skemat e plehimit bazuar në këto analiza.

Gjithashtu me dt.5.02.2017, u organizua takimi me grupin e fermerëve të frutoreve e arroreve në Çorovode-Skrapar, me qëllim demonstrimin e procesit të krasitjes dimerore. Demonstrimi u realizua nga eksperti Bardhosh Ferraj.

Në pjesën e parë të takimit u realizua paraqitja teorike e krasitjes dimerore, rëndësia që ka ky proces në rritjen e prodhimit, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, si edhe në ruajtjen e jetëgjatësisë së pemës.

Në pjesën e dytë të takimit u realizua demonstrimi praktik në fermerë, duke bërë krasitjen në pemtore të fermerëve.

Nga të gjithë fermerët pati një interes të madh për të mësuar procesin e krasitjes. Fermerët paraqiten si të rëndësishëm në të ardhmen trajnimin e fermerëve për krasitje. Gjithashtu, fermerët ngritën si shqetësim plotësimin e kriterëve (dokumentave) dhe vështirësitë për të plotësuar dhe përparitur dosjen e aplikimit në kuadër të grantit 'SARED'. Për këtë qëllim, u vendos që në *periudhën shkurt-*

mars te zhvillohet nje trajnim mbi kerkesat dhe kriteret e grantit 'SARED', qe do te prezantohet nga koordinatorja Rajonale Berat e projektit SARED, znj. Qamile Gishti.

Lehtesuesi i Qendres "ISBUR"

Besmira Osmani

